



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr. 337, datë 25.10.2021

**PËR CAKTIMIN E PROKURORIT NË POZICIONIN VAKANT NR. 3 NË  
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË SHPALLUR ME  
VENDIMIN NR. 332, DATË 29.12.2020 TË KËSHILLIT TË LARTË TË  
PROKURORISË SIPAS PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 44 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Caktimin e Znj. **Ledina Riza** në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, shpallur me Vendimin nr.332, datë 29.12.2020.
2. Të njoftohen për këtë vendim Znj. **Riza**, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.11.2021 dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEIFI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KËSHI**

**ANËTAR  
MOISI DUDA**

**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**

